

R E P U B L I K A E K O S O V E S
/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO/
GJYKATA THEMELORE NE MITROVICË /OSNOVNI SUD U MITROVICI /BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr. 02/2010

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesit nga Mitrovica te cilin e perfaqson Avokat; nga Mitrovica sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditures; Komuna e Mitrovices te cilen e perfaqson Avokati Publik Komunal baza e kontestit ; Vertetim pronesie, vlera e lendet se kontestit 1.250,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.04.12 2014 jep kete;

A K T G J Y K I M

I-APROVOHET kerkespadia e paditesit nga Mitrovica dhe **VERTETOHET** se paditesi eshte shfrytzues i perhershem i pjeses se ngastres katastrale nr. 2915-27 me kultur are e kl. 3, ne vendin e qujtur "Ekonomia e Qytetit Iberne ", me siperfaqe prej S= 346m² , si dhe pronar i objektit-shtepise te cilen e ka ndertuar ne te ne siperfaqe prej 96m², me masa dhe kufi qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes e cila evidentohet ne emer te P.SH Kuvendi Komunal 1/I, ZK-Mitrovice,, sipas Qertifikates se pronesise 3300 ZK-Mitrovice.

II- DETYROHET te paditua qe ti njoh kete te drejte paditesit dhe te lejoje qe paditesi kete palujtshmeri ta regjistrojne ne emer te tije prane Drejtorese per Kataster dhe Gjeodezi ne Mitrovice, ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

Secila pale i barre shpenzimet e veta te proedures kontestimore

A r s y e t i m

Paditesi ne padin e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tije ne seancat e mbajtura ka theksuar se gjate vit. 1994 paditesi konkuroi dhe atij iu nda trolli ne sip. 346m², ne vendin e qujtur si ne dispozitiv te aktgjykimit dhe menjehere filloj ndertimin e shtepise familjare P+1 .

Gjat luftes se vit 1999 ter dokumentacioni ne fjaj iu shkatrrua. Pas perfundimit te luftes, perfundoj ne tersi shtepin dhe u vendos ne te. Pasi qe iu shkatrrua dokumentacioni ai kerkoi nga e paditura por pa sukses te plot perveq qe gjeti protokollin e rregullimit te trollit si investitor si dhe kopjen e planit.

2.

Paditesi u vu ne poseim te truallit ne vit 1994dhe eshte ne posedim edhe tani pa u penguar nga askush.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Perfaqsuesi i te paditures ne perjigje te padise dhe precizimit te kerkespadis se paditesit e kontestoi kerkespadin duke theksuar se se kjo qeshtje juridike nuk hyn ne juridikcionin e gjykates, nga se ter qeshtja duhet te trajtohet dhe percaktohet ne proceduren administrative per rregullimin e statusit dhe regjimit juridik te nderteses ne palujtshmerin e ndare per ndertim te nderteses ne pronesi shoqerore.

Ne fjalen perfundimtare i prpozon gjykastes qe ne baze te rezultatit te provave te nxjerr vendimin perkates.

Shpenzimet e procedures nuk i kerkoi.

Gjykata ne scancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Certifikatat e pronesise Njesia kat. nr. 02915-27 18.04.2014, Ekspertizen e ekspertit gjeodet dt.29.04. 2014 dhe beri veshtrimin ne skicen e terenit nga i njejti ekspert dt. 29.04.2014, Rregullimin e Protokolit Nr. 122 vit. 1994 , Proqesverbalin e kesaje gjykate mi kqryjen ne vend dt.02.04.2014, si dhe ndegjoi deshmitaret; dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Certifikata e pronesise te cekur me larte konstatohet se parc. kat. tani lendore evidentohet ne emer te paditures , sikurse qe eshte cekur ne dispozitiv te aktgjykimit.

Nga konstatimi dhe mendimi i eksperit gjeodet te cekur me larte konstatohet se ; pase matjeve te kryera te pjeseve kontestuese te palujtshmerive nga ana e ekspertit gjeodet dhe ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria e Gjeodezise dhe Katastrit ne Mitrovice, eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese bie -gjegjesishte e perbene parc. e cekur me larte me masa dhe kufij te shenura si ne ekspertizen e dhene me shkrime dhe skicen e terenit te cilat jane pjesa perberse te kesaje ekspertize dhe te aprovur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Nga skicat e terenit te sipercekura, shifet shtrirja , perkufizimi dhe siperfaqja e palujtshmerise tani lendore te paditesit te pare.

Nga Protokoli i rregullimit i vit 1994 shifet se paditesi eshte investitor i objektit; ndertes per banim familjar P+1 ne sip. 96m², ne sip. e truallit prej 346m², ne parc.kat. 2915/1.

Nga proqesverbali mbi kqyrje ne vend i kesaj gjykate i sipercekur vertetohet se; ne palujtshmerin lendore gjendet objekti ndertimor shtepia familjare e banuar P+1 dhe se kjo palujtshmeri eshte e perkufizuar fizikisht.

Deshmitari 1 deklaroi; si fqinje me paditesin e din se i njejti ne vit 1994-5 i njejti ka filluar ndertimin e shtepise se tije per banim e qe te njejten e ka perfunduar pase lufte. Nuk ka njoburi ne qfar baze e ka fituar ket truall. Trolli ne fjal'si dhe tjerat me radhc kan diku [3.6 gjer 3.8 ari].

Deshmitari deklaroi; diku para 4-5 viteve para Lufte gjersa ishte ne pune prane SHKSH- te ai ka shkuar paditesi qe te ben pagesen e trollit te ndar nga e paditura. E din qe paditesi ka paguar 2-3 pagesa per trollin ne fjale, adresuar te paditures. E din qe paditesi ka filluar ndertimin e shtepise dhe tani eshte i vendosur me familje ne te.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte , gjykata erdhi ne perfundim dhe konstatoi se patundshmerin tanjore paditesit i eshte ndare nga ana e te paditures ne vit i cili paraprakisht ka kryer obligimet ndaj te paditures dhe filloj ndertimin e shtepise familjare per banim ne parc, vendin dhe siperfaqen si eshte cekur ne dispozitiv ku menjehet ka hyre ne shfrytzim dhe disponim te kesaje palujtshmerie pa u pengar nga askush qe nga atehet e gjermetani .

Gjithashtu nuk ka ndonje prove se nga e paditura apo ndokush tjeter, kunder paditesit eshte ngritur apo zhvillura ndomjre proceduer lidhur me palujtshmerin tanjore.

Ne baze te nen 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore, Ligji nr. O3/L-154, eshte percaktuar se; Personi i cili me mirbesim e ka njezet [20] vjet ne posedim te panderper nje palujtshmeri ose nje pjese te saje e fiton pronesin ne tc.

Ne rastin konkret paditesi palujtshmerin tanjore e ka fituar ne baze te vendimit te Organit administrativ-te paditures Prandaj paditesit i takon e drejta e shfrytzimit te perhershesh te tokes ne te cilin eshte ndertuar ndertesa si dhe tokes e cila sherben per perdonim te rregullt te kesaje ndertesc.

Gjithashtu nga momenti i ndarjes se ketij trolli ne vit 1994 ,paditesi e ka pasur ne shfrytzim dhe disponim te lire keto palujtshmeri tanjore dhe ate; me mirbesim dhe pa pengesa nga askush. Prandaj ekzistojne te gjitha bazat ligjore per fitimin e pronsise ne baze te mbajtjes e keto jane; mbajtja me mirbesim, koha e nevojshme si dhe shfrytzimi i papengushem i ketyre palujtshmerive.

Mbajtja me mirbesim ekziston se paditesi kete palujtsheri e ka fituar nga pronari juridik dhe faktik i saje.

Koha e nevojshme mbi 20 vite, ekzistn sepse te njejtit kjo palujtshmeri i eshte ndare ne vit.1994

Gjithashtu nga momenti i ndarjes i njejti ka hyre ne posedim dhe shfrytzim te lire dhe te papengushem te kesaje palujtshmerie gjer me tani

Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit me mbajtje, konform nen. 40 te Ligjit per pronesin dhe te drejtat te tjera sendore.

Gjykata vleron te pabazuar prapsimin e te paditures lidhur me kompetencen e gjukates, nga se ne rastin konkret kjo gjykat eshte kompetente per te vendosur lidhur me qeshqen e ngritur nga paditesi, konform nen.. 11.1 te [Ligjit nr. 03/L-199 per gjykatat].

Vendimi mbi shpenzimet e procedures kontestimore , bazohet ne baze te nen. 450 te LPK

Nga si u tha me larte u vendos si ne dispozitive te ketije aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

C.nr.02/2010 dt 04.12.2014

G j y q t a r i,
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE; Kunder ketije aktgjykimi munde te ushtrohet ankesa ne afatin prej 15 diteve nga dita e pranimit, Gjykates se Apelit te Kosoves e permes kesaje gjykate.